2016 2017 2018 2019 2020

EU Policy Hub

In a Year

Vizion 2025

Shqipëria
një vend
anëtar në BE

Solidariteti Dialogu social Lëvizja e lirë Shanse të barabarta Shteti i së drejtës Toleranca Demokracia Mjedisi Lëvizja e lirë Paqja Shteti i së drejtës Shanse të barabarta Demokracia Paqja Dialogu social Toleranca Liria e shprehjes Diversiteti Liria e shprehjes Mirëqenia Mirëqenia Solidariteti Toleranca Mjedisi Diversiteti

Vizion 2025

NE, anëtarët e Forumit të Politikave të Integrimit
EU Policy Hub

çmojmë parimet dhe vlerat mbi të cilat është ngritur Bashkimi Europian, si dhe aspiratën e çdo shqiptari për t'iu bashkuar sa më shpejt familjes së madhe europiane;

vlerësojmë se ritmi dhe cilësia e proceseve demokratike të brendshme, si dhe zhvillimet destruktive në rajon dhe më gjerë mund të kenë pasoja negative jo vetëm për procesin e integrimit europian të vendit, por mbi të gjitha për mirëqenien qytetare;

mbetemi të angazhuar për të shpalosur vizionin tonë për Shqipërinë e së ardhmes si një vend anëtar i denjë i Bashkimit Europian, bazuar në 12 parime dhe vlera themelore;



Shtyllat kryesore të punës së EUPH

Ndërgjegjësim

Informimi i publikut, ngritja e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimi për procesin e integrimit të Shqipërisë në BE, veçanërisht me të rinjtë

Monitorim

Monitorimi i zbatimit të politikave publike bazuar në nevojat dhe sfidat e Shqipërisë në procesin e integrimit në BE

Angazhim

Ushtrimin e ndikimit pozitiv në ecurinë e procesit të integrimit duke nxitur debatin publik për anëtarësimin e Shqipërisë në BE

Partneritet

Rrjetëzim me organizatat dhe ekspertët nga vendi dhe rajoni që ndajnë vlera dhe objektiva të përbashkëta Europiane

Ndërgjegjësim Qytetar

Ndërgjegjësimi qytetar, ka për qëllim promovimin e vlerave europiane dhe ndërgjegjësimin e opinionit publik mbi ndikimin dhe përfitimet që sjell integrimi në Bashkimin Europian. Vetë procesi i integrimit, më shumë sesa agjendë institucionale, është një angazhim qytetar që duhet mbështetur nga shoqëria civile. Demokracia vendore, e vënë në lëvizje nga nisma aktivistësh, është një vlerë europiane që duhet promovuar vazhdimisht.

Nismat e ndërgjegjësimit qytetar synojnë forcimin dhe promovimin e bashkëpunimit mes shoqërisë civile dhe pushtetit qendror dhe vendor, krijimin dhe lehtësimin e mënyrave të pjesëmarrjes së komuniteteve në proceset vendim-marrëse gjatë hartimit dhe zbatimit të politikave publike në nivel vendor.

Motoja e nismave të ndërgjegjësimit qytetar është aktivizmi dhe përgjegjësia qytetare si dhe bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm për të çuar përpara kauza me interes publik.

Ndërgjegjësim Qytetar

Për një 'Jetesë të Pavarur' për personat me aftësi të kufizuar, në bashkëpunim me Fondacionin "Së Bashku", në 5 maj 2017

Start-up Albania

Në bashkëpunim me 'Oficina' i ofrojnë qendrës Ekologjike të Degustimit çmimin EU Policy Hub

Në mbrojtje të Parkut Kombëtar të Karavastasë – Divjakë, në bashkëpunim me të rinjtë u mbollën 60 fidanë të rinj

Prezantimi i Manualit për Qytetarët



Jam e sigurt se manuali që keni në duar do t'iu ndihmojë për të mësuar dhe kuptuar më mirë të gjitha mundësitë që procesi i zgjerimit sjell për vendin tuaj. Lexim të këndshëm dhe ri-kthejuni këtij manuali sa më shpesh të jetë e mundur!

Romana Vlahutin, Ambasadore e Bashkimit Europian në Shqipëri

Debate 20 Qytete

një rrugëtim për të prezantuar manualin për qytetarë

Prezantimi i Manualit për Qytetarët

Debate 20 Qytete

një rrugëtim për të prezantuar manualin për qytetarë

Integration Talks

Unë shpresoj të shoh më shumë media të pavarura në Shqipëri. Mendoj se kjo është shumë e nevojshme

Dewi Van De Weerd, Ambasadore e Mbretërisë së Holandës në Shqipëri

Çështjet e integrimit europian diskutohen gjerësisht midis grupeve të elitës në shumë nga kryeqytetet europiane. Forumi i Politikave të integrimit, nëpërmjet nismës *Integration Talks* dëshiron ta shndërrojë këtë praktikë Europiane në një element pozitiv të nxitjes dhe zhvillimit të një debati cilësor dhe ndërveprimi midis anëtarëve të shoqërisë civile, politik-bërësve dhe akademikëve.

Nisma është ideuar si një shkëmbim njohurish dhe mendimesh mes personaliteteve të ftuara me eksperiencë në çështje specifike, përfaqësuesve të forumit dhe një audience të kufizuar në mënyrë që të krijohet një hapësire dialogu ndërmjet të pranishmëve.

Integration Talks

27 tetor

Reforma në drejtësi:
Një bisedë me z. Ardian Dvorani,
Gjyqtar i Gjykatës së Lartë

7 Qershor

Roli i medias dhe integrimi i Shqipërisë
në BE, Universiteti i Elbasanit

16 Janar

Transparenca e gjykatave dhe
roli i gjyqtarit për mediat
Marc Bax, gjyqtar nga Holanda

31 Maj

Progresi i Shqipërisë dhe sfidat drejt
rrugës në Bashkimin Europian,
Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës

16 Mars

Media pro-aktive dhe
e përgjegjshme

17 Maj

Reforma në drejtësi
Dr. Agnes Bernhard, EURALIUS IV

Hub Monitor

Forumi i Politikave të Integrimit monitoron nga afër procesin e integrimit në Bashkimin Europian dhe institucionet e përfshira në të, duke u përqendruar kryesisht në koordinimin ndërinstitucional ndërmjet njësive dhe dokumenteve dhe raporteve të tyre ligjore. Treguesit e monitorimit dhe rregullat metodologjikë përfshijnë aktet normative dhe/ose legjislative të miratuara; aktivitetet e kryera (numri I takimeve, plan-veprimeve, raportet, strategjitë për të adresuar mangësitë e identifikuara nga raporti i KE, etj.); fazën e zhvillimit paraprakisht të instrumenteve; si dhe shqyrtimin institucional dhe publik të rezultateve të arritura

Institucionet koordinuese dhe strukturat e integrimit në BE: Pse janë të rëndësishme?

Mësimet e nxjerra nga ndërhyrja e fondeve IPA në Shqipëri

Aftësitë e planifikimit strategjik dhe roli i ekzekutivit në procesin e anëtarësimit në BE

Ruajtja e natyrës dhe rëndësia e saj në procesin e integrimit

Kërkohet dialog: Eksperienca e bashkëpunimit ndërparlamentar BE-Shqipëri

Reforma në drejtësi dhe hija e ekzekutivit: Roli i ri i Ministrisë së Drejtësisë në qeverisjen gjyqësore në Shqipëri

Mbështetja buxhetore: Një mjet për të zbatuar asistencën financiare të Bashkimit Europian

Ballkani Perëndimor & Procesi i Berlinit

Objektivat

Të vlerësojë shkallën e reformave që rrjedhin nga Procesi i Berlinit dhe kontributin e tyre në rritjen e bashkëpunimit rajonal dhe përmirësimit të politikë-bërjes në Ballkanin Perëndimor

1) vlerësimi i efekteve të Procesit të Berlinit tek gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor për sa i përket procesit të integrimit në BE, bashkëpunimit rajonal, dhe progresi i arrirë në sferat përkatëse;
2) kryerja e aktiviteteve monitoruese për sa i përket RYCO-s, mosmarrëveshjeve dypalëshe dhe agjendës së konektivitetit;
3) advokimi për përfshirje strukturore të OJQ-ve në procesin politikë-bërës në nivel kombëtar dhe rajonal në vendet e Ballkanit Perëndimor

Rezultatet

1: **Dokument politikash** rajonal mbi zbatimin e angazhimeve të ndërmarra nga qeveritë e Shqipërisë, Bosnje dhe Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë për sa i përket bashkëpunimit rinor, ndërlidhjes infrastrukturore dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dypalëshe, si dhe pjesëmarrja e shoqërisë civile në këtë fushë.

2: **Dokument politikash** rajonal që vlerëson efektet e Procesit të Berlinit në rajonin e Ballkanit Perëndimor për sa i përket procesit të integrimit në BE dhe bashkëpunimit rajonal midis shteteve.

3: Tre **aktivitete advokimi** me aktorët kryesorë organizuar në tre vende të Ballkanit Perëndimor, bazuar në rekomandimet e projektit.

Ballkani Perëndimor & Procesi i Berlinit

"Procesi i Berlinit. Çfarë funksionoi dhe çfarë jo? Dhe pse?", Ky dokument politikash synon të vlerësojë progresin e arritur në disa politika, si bashkëpunimi rajonal, agjenda e konektivitetit dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve dypalëshe, si dhe kërkon të shpjegojë pse Procesi i Berlinit ka qenë më i suksesshëm në disa fusha specifike.

6 Korrik, Tiranë

EU Policy Hub, ishte partner i projektit rajonal mbi monitorimin e Procesit të Berlinit. Në këtë kuadër u promovua në një aktivitet publik në Tiranë dhe gjatë Samitit të Triestes dokumentet e politikave mbi arritjet e këtij procesi.

Për më shumë vizibilitet, eficiencë dhe efektivitet: Procesi i Berlinit 2.0" u promovua në dhjetor në Shkup. Ky punim i dytë synoi të kontribuojë me rekomandime konkrete për një vizibilitet, monitorim, institucionalizim dhe efikasitet më të lartë të Procesit të Berlinit përgjatë katër vjeçarit të ardhshëm.

Politika Shqiptare për Zhvillim Ndërkombëtar & Roli i OSHC-ëve në Perspektivën e Anëtarësimit në BE

5 Nëntor, Bratislavë

Ky dokument politikash prezanton situatën aktuale në Shqipëri dhe praktikat më të mira të mundshme në trajtimin e politikës për zhvillim ndërkombëtar dhe ndihmës humanitare nën dritën e hapjes së negociatave për anëtarësim në BE

Objektivat

Të vlerësojë situatën aktuale të Shqipërisë në zhvillimin ndërkombëtar dhe ndihmën humanitare dhe ta krahasojë atë me praktikat më të mira nga vendet e tjera të rajonit;

Të theksojë rolin kritik që shoqëria civile duhej të luajë në politikën e zhvillimit ndërkombëtar në kontekstin europian, si dhe përpjekjet për të identifikuar mundësitë dhe sfidat e integrimit të OShC-ve shqiptare në bashkëpunimin rajonal të shoqërisë civile dhe rrjetet për zhvillim ndërkombëtar.

Rezultatet

- Hartimi i dokumentit të politikave
- Prezantimi në Konferencën Ndërkombëtare për Zhvillim dhe Demokraci në Bratislavë
- Aktivitet advokimi në Tiranë me aktorët kryesorë

6 Qershor, Tiranë

Atelier Europe Tirana

"Atelier Europe – Tirana" synon të rrisë mirëkuptimin dhe promovimin e vlerave themelore europiane në Shqipëri, në funksion të procesit të integrimit të vendit në BE.

BE nuk është vetëm negociata, marrëveshje dhe politikanë, mbi të gjitha janë gjithashtu bashkësi vlerash, objektivash dhe vizioni se si të sjellim prosperitet dhe rritje të cilësisë së jetës së qytetarëve.

"Atelier Europe – Tirana" është një nismë gjithëpërfshirëse, e cila ka karakter shumëdimensional, duke organizuar ngjarje të ndryshme shoqëroro-kulturore, ekspozita arti dhe shfaqjen e filmave dokumentarët të cilat kanë në vëmendje vlerat europiane.

Kjo nismë synon të shndërrohet në një "Culture Hub" për të pritur dhe promovuar artistë të rinj dhe ide të reja arti, rritjen e kapaciteteve të tyre dhe stimulimit të bashkëpunimit me partnerë të tjerë nga rajoni dhe BE-ja.

Atelier Europe - Tirana

19 Prill

Shfaqja e filmit **"Hijet" (Shadows)** dhe diskutim me regjizorin e ri Jotti Ejlli

23 Maj

Shfaqja e doku-filmit **"Comizi d'Amore"** të Pier Paolo Pasolini. Diskutim me ekspertin e kinemasë Orest Zeneli mbi aspektet sociale, antropologjike dhe kulturore të filmit

08 Korrik

"Comizi sull'Arte e sul Femminismo"
Shfaqje teatrale e cila nxjerr në pah kushtet e vështira të punës që përjetojnë vajzat sot (ATA)

29 Shtator

Paper 'n' Sound – Live
Emision i një formati të veçantë radiofonik që ndërthur poezinë & muzikën në një krijim të vetëm (Diana Malaj dhe Altin Sulaj)

21 Tetor

"Muzika e të Rinjve" edukimi i fëmijeve Rom nëpërmjet muzikës. (muzikanti Vitmar Basha).
Koncert muzikor në mbështetje të fëmijëve Rom me qëllim mundësimin e disa të ardhurave për blerjen e ilaçeve dhe veshje për fëmijë.

2018

Galeria 'Unë dhe Europa'

Galeria 'Unë dhe Europa' u organizua në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar 7-16 Dhjetor si një formë e shprehjes alternative dhe komunikimit estetik të procesit të integrimit europian me qytetarët, nëpërmjet fotografive, videove, instalimeve dhe organizimit të debateve të synuara me grupe të caktuara.

Pavarësisht se kjo linjë kohore e gjatë mbi procesin e integrimit prezanton arritjet dhe sfidat shpresojmë që hapi i radhës në 2018 të jetë hapja e negociatave.

Themeluesit

FONDACIONI SHOQËRIA E HAPUR PËR SHQIPËRINË

FRIEDRICH EBERT STIFTUNG

Donatorë

Kingdom of the Netherlands

10 YEARS OF THE EUROPEAN FUND FOR THE BALKANS

SlovakAid
GOOD IDEA SLOVAKIA

Organizata Partnere

Fondacioni "Së Bashku"

Qendër Rinore Komunitet Bibliotekë Edukim Argëtim Lëvizje Motivim Poem Utopi ATA Gjini Liri Art Kinema Dedikim Identifikim Synim Lexim Akt Punëtori Ngjyrë Protagonist Ligjëratë

T'REJA

IDSCS Institute for Democracy Societas Civilis -Skopje

pontis foundation



Adresa: Rr. Qemal Stafa,
Pallati 120/2, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 69 281 7502
E-mail: info@eupolicyhub.eu
Web: www.eupolicyhub.eu
Facebook: EuPolicyHubAlb
Twitter: eupolicyhub
Youtube: EU Policy Hub